

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË **POSTA SHQIPTARE SH.A.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Posta Shqiptare SHA, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri 30.09.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 49, datë 30.04.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për oraganizimin dhe funksionimi e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 1053/23, datë 30.04.2015 dërguar Z. Majlind Lazimi, Drejtor i Përgjithshëm i Posta Shqiptare Sh.a. dhe shkresën nr. 1053/25 datë 30.04.2015 dërguar Agjencisë së Prokurimit Publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

- Nga rekomandimet e dhëna në auditimin e mëparshëm rezulton se janë realizuar plotësisht, janë në proces ose realizuar pjesërisht 20 masa organizative nga 22 gjithsej; nga 3 masa për shpërbllim dëmi nuk është realizuar një masë në vlerën 102,569 lekë për përfitim të padrejtë të shpenzimeve telefonike; si dhe nga masat disiplinore të rekomanduara për 20 punonjës janë marrë në konsideratë dhe zbatuar plotësisht.

1. Për këtë rekomandojmë që, Këshilli mbikëqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë të analizojnë me përgjegjësi dhe të marrin masat e nevojshme për realizimin e plotë të rekomandimeve të pa realizuara, të realizuara pjesërisht dhe në proces të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Menjëherë

- Gjatë veprimtarisë së këshillit mbikëqyrës:

- Janë marrë vendime për të cilat nuk janë të dokumentuara në protokollin e mbledhjeve, si dhe në shumicën e rasteve, relacionet e çështjeve të rendit të ditës nuk ju janë vënë në dispozicion 10 ditë para mbledhjes anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, duke ngarkuar me përgjegjësi drejtuesit e shoqërisë;
- Nuk ka raportuar për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë në ministrinë e linjës dhe Ministrinë ZHETS, si dhe nuk e ka zhvilluar veprimtarinë e tij nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve mbi bazën e një programi vjetor të miratuar për aktivitetin e drejtorisë dhe të mbledhjeve të tjera të posaçme të kërkuara nga vetë këshilli apo drejtoria;
- Nuk ka përcaktuar më parë numrin e anëtarëve të drejtorisë, si dhe nuk ka lidhur kontrata vjetore me drejtorinë për administrimin e shoqërisë, si dhe nuk ka verifikuar dhe kontrolluar brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar, raportin e drejtorisë dhe të ekspertit kontabël të autorizuar;
- Nuk është dokumentuar dërgimi i një kopje të vendimeve të këshillit mbikëqyrës në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike në MZHETS, si dhe mungesa e CV së anëtarëve të këshillit mbikëqyrës nuk mundësoj auditimin e kriterëve të emërimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

2. Për sa më lart rekomandojmë që Këshilli mbikëqyrës:

- ***Të raportojë në Ministrinë e linjës dhe në MZHETS për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë jo më pak se 4 herë në vit, duke filluar që nga tremujori i parë 2015;***
- ***Të dërgojë në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike në MZHETS një kopje të vendimeve të këshillit mbikëqyrës për të gjithë veprimtarinë e tij;***
- ***Të hartojë dhe miratojë menjëherë programin vjetor të veprimtarisë për aktivitetin e drejtorisë dhe të mbledhjeve të tjera të posaçme të kërkuara nga vetë këshilli apo drejtoria, si dhe të përcaktojë më parë numrin e anëtarëve të drejtorisë, si dhe të lidhë kontrata vjetore me drejtorinë për administrimin e shoqërisë.***

- Të sigurojë nga drejtoria e shoqërisë vënien në dispozicion të relacioneve 10 ditë para zhvillimit të mbledhjes, për të marrë vendime të dokumentuara në protokollin e mbledhjeve, verifikuar dhe kontrolluar në afat raportin e drejtorisë dhe të ekspertit kontabël të autorizuar.

Vazhdimisht

- Të analizojë veprimtarinë ekonomike dhe financiare të shoqërisë “Interposta” SHPK me ortak të vetëm Posta shqiptare SHA, pasi ky subjekt ka zhvilluar aktivitetin e vet në treg prej tre vjetësh dhe rezulton me humbje që nga themelimi, duke i rekomanduar asamblesë së përgjithshme (MZHETS) marrjen e masave përkatëse ligjore.

Menjëherë

- Në auditimin e veprimtarisë së Drejtorisë rezultoi se:

- Është marrë vendim për të kaluar në shpenzime konsumin e karburantit për 300 litra në muaj për drejtoreshën e komanduar në filialin Durrës, në mënyrë të pabazuar ligjërisht, duke rënduar shpenzimet e shoqërisë;
- Kanë kaluar në shpenzime të shoqërisë konsumin për telefon celular personal (roaming) për dy drejtues në shumën 168,246 lekë të cilët përbëjnë dëm ekonomik;
- Është propozuar shpërblimi i këshillit mbikëqyrës mbi një interpretim të gabuar të kuadrit ligjor për veprimtarinë shoqërive publike, si dhe në rastin e pagesës së TVSH për Udhëzimin nr. 17, datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” me ndryshime;
- Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2012, janë miratuar dy muaj me vonë nga afati i përcaktuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29, pika 1: paraqitja e deklaratës vjetore në organet tatimore bëhet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës;
- Janë tejkaluar kompetencat në miratimin e çmimeve të shitjes së zarfeve FDC, Karnetit, Albumit dhe kursin e konvertimit në euro për emisionet e pullës 2013, pasi në zbatim të VKM nr. 405, datë 27.7.2000 “Për kushtet e nxjerrjes së pullës postare shqiptare” miratimi i tyre bëhet nga ministri përkatës;
- Ka raste të largimit nga puna dhe/ose të lirimit dhe emërimin në një detyrë tjetër, pa shkaqe të arsyeshme, duke rrezikuar penalizimin e shoqërisë nga vendimet gjyqësore për keqadministrim të marrëdhënieve të punës;
- Plani i investimeve për vitin 2014 është miratuar jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 315 datë 08.04.2009;
- Është miratuar marrja me qira e ambienteve për nevojat të veprimtarisë së shoqërisë, pa përdorur procedura konkurruese të njoftimit në media, për të rritur transparencën dhe efektivitetin e fondeve publike;
- Është dhënë me qira një sipërfaqe prej 56.2 m² me afat 2 vjeçar, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, pika 5, pasi nuk jepen për afat mbi 1 vit, si dhe nuk janë përfshirë shpenzimet për energji elektrike dhe ujë.

3. Për sa më sipër rekomandojmë që:

- **Drejtoria e shoqërisë të ndajë përgjegjësitë midis zëvendësrejtoreve për të rritur performancën e funksionimit dhe rolin e tyre në strukturat vartëse, duke ju kërkuar llogari atyre, si dhe duke raportuar dhe dhënë llogari tek Drejtori i Përgjithshëm;**
- **Drejtoria e shoqërisë të rishikojë kontratën e dhënies me qira të ambienteve me sipërfaqe 56.2 m² në drejtim të afatit dhe përfshirjes në kontratë të shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë për llogari të qiramarrësit.**

Menjëherë

- **Drejtoria e shoqërisë, gjatë vendim-marrjes për raste të veçanta shpenzimesh, të thellojë analizën përkatëse në drejtim të argumentimit në përpunime me kuadrin rregullator përkatës;**

- **Drejtoria e shoqërisë, nëpërmjet raportimit dhe analizës së vazhdueshme të sigurojë respektimin e kërkesave ligjore për rrethanat dhe afatet e miratimit të pasqyrave financiare, administrimin e marrëdhënieve të punës si dhe prokurimeve publike, përfshirë dhe rastet e qiramarrjes;**

- **Drejtoria e shoqërisë të shmangë rastet e shpeshta të largimit nga puna pa shkaqe të arsyeshme, për të minimizuar penalizmin e shoqërisë nga vendimet gjyqësore, si dhe lirimet dhe emërimet e shpeshta dhe të shpejta të stafit dhe personelit të shoqërisë, pasi në këtë mënyrë ulet performanca e burimeve njerëzore dhe për pasojë ajo e shoqërisë;**

Vazhdimisht

- Gjatë periudhës së audituar, nuk janë realizuar treguesit ekonomik dhe financiar: për vitin 2013 janë realizuar në masën 90 % dhe treguesit e 9-mujorit të vitit 2014 janë realizuar në masën 97,7%, në krahasim me përcaktimet në programin vjetor.

4. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë të analizojë vazhdimisht dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse në mënyrë periodike për ecurinë e realizimit të treguesve ekonomik dhe financiar, me synim për të shmangur mosrealizimet e treguesve.

Vazhdimisht

- Procedurat e ndjekura për hartimin, miratimin e projekt-programit ekonomik për vitet 2013 dhe 2014, janë në shkelje të afateve dhe procedurave për dërgimin në MZHETS (ish METE), në kundërshtim me kreun III, pikat 3, 4 dhe 5 të Udhëzimit nr. 315, datë 8.04.2009, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”.

5. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për të zbatuar procedurat për hartimin dhe miratimin e projekt-programit ekonomik të zhvillimit të shoqërisë, në përputhje me afatet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 315, datë 8.04.2009, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” dhe statutin e shoqërisë” me ndryshimet e mëvonshme.

Gjatë hartimit të programit ekonomik

- Për vitin 2013 dhe 2014, vlerat e investimeve gjithsej dhe analitikisht sipas zërave rezultojnë me mosrealizim të theksuar: në 2013 është realizuar në masën 17.4% dhe në 9-mujorin e vitit 2014, akoma më pak, vetëm 14.7 %, krahasuar me vëllimin e investimeve në programin ekonomik.

6. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për hartimin dhe realizimin e programit të investimeve sipas programit miratuar në MZHETS, me qëllim që të mbështesë dhe të realizojë strategjinë e vet të zhvillimit ekonomik dhe financiar në drejtim të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe rritjes së fitimit.

Vazhdimisht

- Nga auditimi i dokumenteve të arkës dhe bankës si dhe blerjet me vlera të vogla rezultoi se:

- Në 10 raste me vlerë 91 mijë lekë gjithsej, veprimet e kryera me arkë për rastet e blerjeve me vlera të vogla mungon kuponit tatimor krahas faturës përkatëse;
- Në disa raste, dokumentacioni financiar justifikues nuk është i plotë, nga të cilat në dy raste për mallra dhe kryerje shërbimesh me blerje të vogla me vlerë 789,000 lekë, dokumentacioni ka mungesa thelbësore, duke sjellë dëm ekonomik për shoqërinë;
- Në shqyrtimin e dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për reklamë-publicitet, lind dyshimi i arsyeshëm se shpallja e subjektit fitues ka qenë i paracaktuar, si dhe nga mangësitë për vlerën e prodhimit të një spoti televiziv, radiofonik dhe faqe gazete të paraqitura për të gjitha së bashku, vlera prej 1,765,000 lekë gjithsej përbën dëm ekonomik;
- Nuk është hartuar regjistri i prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2013 e 2014, si dhe nuk është bërë raportimi periodik i realizimit për vitin 2013.

- “Interposta SHPK” ka kryer 5 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla në shumën gjithsej 1,956,720 lekë, për kryerjen e shërbimeve për të njëjtin aktivitet, duke shmangur procedurat e prokurimit me tender të hapur.

Për sa më sipër rekomandojmë që:

7. Drejtoria e shoqërisë të marrë masa për hartimin e regjistrit të prokurimeve të blerjeve me vlera të vogla, duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat nga njësitë vartëse, si dhe të raportojë periodikisht për realizimin e tyre, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Menjëherë

8. Drejtoria e shoqërisë, të hartojë dhe të zbatojë një kalendar të qartë të nevojave për reklamë dhe publicitet, si dhe të zbatojë me rigorozitet kërkesat ligjore gjatë zhvillimit të këtyre procedurave dhe zbatimit kontratave përkatëse, në funksion jo vetëm të efektivitetit të përdorimit të fondeve, por edhe të ndikimit në zhvillimin e shoqërisë.

Vazhdimisht

- Nga auditimi i marrëdhënieve të punës rezulton se:

- Për vitin 2013 nuk është plotësuar numri mesatar i punonjësve me 44 veta, paga mesatare e realizuar është 1,037 lekë më pak se ajo e programuar, e reflektuar kjo me një “kursim” në fondin e pagave në shumën prej 49 milion lekë. Fakti i mosrealizimit të treguesve ekonomik dhe financiar në këtë vit, ka qenë i ndikuar edhe nga ky faktor.

- Në periudhën janar-shtator të vitit 2014, është tejkaluar numri mesatar i punonjësve me 14 persona, paga mesatare e realizuar është 1,949 lekë më pak se ajo e programuar dhe për pasojë fondi i pagave ka një mosrealizim në shumën 12 milion lekë.

9. Për sa më lart rekomandojmë që, Drejtoria e Përgjithshme e shoqërisë, bazuar në aktivitetin e Drejtorisë së burimeve njerëzore, të analizojë në mënyrë periodike treguesit e fuqisë punëtore (numrin mesatar të punonjësve, pagën mesatare dhe fondin e pagave) në përputhje me objektivat ekonomik dhe financiar të shoqërisë, pasi rastet e tejkalimeve të fuqisë punëtore janë shkelje e disiplinës financiare, si dhe mosrealizimi i pagës mesatare ndikon në performancën e punonjësve dhe për pasojë dhe në atë të shoqërisë.

Çdo tremujor

- Shoqëria Posta Shqiptare për periudhën objekt auditimi, është penalizuar nga vendimet e gjykatave për largimet nga puna pa shkaqe të arsyeshme në shumën 18,863,895 lekë, nga të cilat për vitin 2013 janë në shumën 3,792,859 lekë dhe për 2014 në shumën 15,071,036 lekë. Gjithashtu, rezulton se për largimet nga puna në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare, janë të hapura 25 çështje gjyqësore, për të cilat sipas përlllogaritjeve, shuma e kërkuar nga punonjësit është 14,409,744 lekë, ndërsa në filialet e postës në total janë 267 raste të tjera për zgjidhjen e kontratave të punës, shpenzimet që do të rëndojnë drejtpërdrejtë në rezultatin financiar të shoqërisë.

10. Për sa më lart rekomandojmë që, Këshilli mbikëqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë të analizojnë në mënyrë të hollësishme të gjitha rastet e largimit nga puna, duke evidentuar përgjegjësitë individuale për këto humbje të konsiderueshme të shoqërisë, si dhe të përcaktojnë dhe të ndjekë procedura të rregullta ligjore për largimet nga puna, me qëllim shmangien e shpenzimeve për pagesa të vendime gjyqësore të cilat ndikojnë në rezultatin financiar të shoqërisë.

Deri në muajin qershor 2015

- Nga kontrolli me zgjedhje i 20 dosjeve të nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme, konstatohet se dokumentacioni në përgjithësi është në përputhje me përcaktimet në kontratën kolektive, me përjashtim të disa rasteve me mungesa të pjesshme në dokumentacion, por të gjitha dosjeve të personelit ju mungon inventari përkatës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” në Republikën e Shqipërisë”.

- Rekrutimi është bërë në përputhje me kriteret e vendosura paraprakisht në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë etj., por procedura e ndjekur gjatë rekrutimit nuk është plotë, si dhe nuk ka gjurmë për shpalljen e vendeve vakante dhe intervistimin ose testimin e kandidatëve deri në përzgjedhjen përfundimtare të tyre.

11. Për sa më lart rekomandojmë që, Drejtoria e Posta Shqiptare SHA, të hartojë dhe zbatojë plotësisht procedurat rekrutimit të punonjësve, si dhe të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të personelit, dhe inventarizimin në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

- Posta Shqiptare SHA nuk ka përshtatur Rregulloren e brendshme të funksionimit, me ndryshimet e fundit të strukturës organizative në korrik të vitit 2014, duke ndikuar negativisht në përgjegjësinë dhe performancën e nëpunësve të saj dhe për pasojë dhe në atë të shoqërisë, periudhë e cila ka pasur edhe ndryshimet e para në strukturën e shoqërisë, të cilat janë pasuar.

12. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë të shmangë ndryshimet e shpeshta strukturore në qendër dhe në filiale, si dhe brenda një kohe të shkurtër të hartojë dhe të miratojë Rregulloren e brendshme, në funksion të përmirësimit të administrimit dhe menaxhimit të shoqërisë.

Deri në muajin qershor 2015

- Posta Shqiptare SHA akoma nuk ka hartuar dhe miratuar Kodin e etikës për marrëdhëniet e personelit brenda shoqërisë, si dhe me qytetarët (klientët).

13. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë, të marrë masa në hartimin dhe miratimin e Kodit të etikës, me synim që të rritet performanca e nëpunësve të saj, duke përmirësuar cilësinë e punës dhe shërbimit ndaj qytetarëve dhe më gjerë.

Deri në muajin korrik 2015

- Posta Shqiptare SHA, nuk ka përfituar asnjë pagesë për transferimin në masën 3 % të aksioneve të kapitalit të investuar që nga vitit 2009 në subjektin privat Albatelecom SHA, si dhe organet drejtuese të shoqërisë, nuk kanë bërë analiza dhe nuk kanë marrë vendime për të vlerësuar përfitimet e këtij investimi si pjesëmarrje në aksione.

14. Për këtë rekomandojmë që, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria e shoqërisë të analizojnë situatën në lidhje me arkëtimet detyrimeve të prapambetura për pjesë të fitimit për 3 % të aksioneve në Albatelecom SHA, duke i propozuar Asamblesë (MZHETS) veprimet e mëtejshme për këtë përqindje aksionesh në Albtelekom SHA.

Deri në muajin korrik 2015

- Posta shqiptare SHA, në fund të vitit 2012, ka kryer rivlerësimin e pasurisë së shoqërisë, pa përfunduar më parë procesi për pajisjen me vërtetime pronësie, pasi nuk është kryer akoma hipotekimi i pronave në 10 filiale për 86 zyra postare, pra pajisja me certifikatë pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 556, datë 23.10.2000 “Për hipotekimin e pasurisë në shoqëritë publike” dhe VKM nr. 553, datë 28.08.1998 “Për regjistrimin pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore”.

15. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë Posta Shqiptare SHA, të marrë masa të menjëhershme për të përfunduar veprimet përkatëse procedurale për hipotekimin e pronave në 10 filiale për 86 zyra postare, me qëllim pajisjen me certifikata të pronësisë në të gjithë pasurinë e saj.

Brenda vitit 2015

- Nga auditimi rezulton se më datë 31.12.2013, Posta shqiptare SHA, megjithëse ka pasur sasi të konsiderueshme të mjeteve monetare në bankë, nuk ka marrë masa për të ulur detyrimet ndaj të tretëve për marrëveshjet e lidhura në kryerjen e shërbimeve, të cilat përfaqësojnë detyrime

gjithsej të trashëguara ndër vite në shumën 1,339 milion lekë, përfshirë 100.5 milion lekë detyrime të shtuara gjatë vitit 2013.

16. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë Posta Shqiptare SHA, të marrë masat e nevojshme që të shlyejë detyrimet debitore të trashëguara ndër vite që ka ndaj furnitorëve për shërbimet dhe blerjen e mallrave të ndryshme, me mjetet monetare që ka gjendje në llogaritë bankare, duke shmangur penalizmin e mëtejshëm për shkak të rritjes së kësaj kostoje.

Brenda vitit 2015

- Si pasojë e evidentimit dhe regjistrimit jo të saktë të veprimit kontabël nga financa e “Interposta” SHPK në bilancin kontabël për vitin ushtrimor 2013, ka rezultuar me gjendje si klientë në llogarinë “Të arkëtueshme tregtare” në shumën 53,516,201 lekë, vlerë e cila në fakt përfaqëson kostot e pajisjeve të kaluara falas në institucione të tjera, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me këto institucione, pra që duhej konsideruar në zërin shpenzime, duke rënduar rezultatin financiar të “Interposta” SHPK.

17. Për këtë rekomandojmë që, “Interposta” SHPK të marrë masa për të pasqyruar llogaritë kontabël në përputhje me SKK, të klasifikuara sipas natyrës si shpenzime. Për këtë dega e financës të sistemojë veprimet në kontabilitet për “Llogari të arkëtueshme tregtare”, në shumën 53,516,201 lekë, duke i kontabilizuar në rezultatin financiar të saj.

Deri në muajin qershor 2015

- Nga auditimi i kryer rezulton se, Posta shqiptare SHA ka kërkesa të pa arkëtuara për detyrime pa shpresë arkëtimi të krijuara që nga viti 1996 në shumën 12,204,000 lekë. Nga kjo shumë, detyrimet në vlerën 4,672,000 lekë përfaqësojnë vlerën e dy makinave të vjedhura në vitin 1997 (çështje e mbyllur nga organet gjyqësore për shkak të mungesës së provave), ndërsa detyrimet e tjera në shumën 7,532,000 lekë, janë krijuar nga subjekte gjatë periudhës 1996-1997 të cilat nuk ekzistojnë, pasi kanë mbyllur aktivitetin e tyre dhe për me tepër nuk mund të ndiqen në rrugë gjyqësore për shkak të tejkalimit të afateve. Pra shumatat e mësipërme janë kërkesa për t'u arkëtuar nga shoqëria por që nuk kanë shpresë arkëtimi.

18. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë Posta Shqiptare të marrë masa për të provizionuar gjendjet në llogarinë “Kërkesa të tjera të arkëtueshme”, në shumën 12,204,000 lekë, pasi të merret më parë miratimi në Këshillin Mbikëqyrës, si detyrime të krijuara që nga viti 1997 e në vazhdim dhe nuk kanë shpresë arkëtimi as në rrugë gjyqësore.

Deri në muajin tetor 2015

- Posta Shqiptare SHA, në të gjitha procedurat e investimit të parave në depozita bankare të kryera gjatë vitit 2013, janë vërejtur parregullsi në dokumentacione, ofertat nga bankat janë pranuar me shumë ditë vonesë deri në dy muaj, grupi i punës të menaxhimit të aseteve ka paraqitur relacionet te Drejtori i Përgjithshëm në mënyrë formale pasi janë pa numër protokolli dhe pa datë. Vendimet e drejtorisë për miratimin e bankës në të cilën do vendosen depozitat, janë marrë në mungesë të ofertave të paraqitur nga bankat, për pasojë normat e interesit të ofruara nga bankat nuk përputhen me datën kur drejtoria ka miratuar që të bëhet depozita. Në dy raste janë lidhur kontrata me bankat pa u marrë më parë vendimi për miratimin nga drejtoria e shoqërisë dhe pa u mbledhur grupi i punës për shqyrtimin e ofertave, për të përzgjedhur bankën me normën e interesit më të lartë. Në 4 raste mungojnë kontrata e lidhura nga Drejtori i përgjithshëm dhe bankat ku janë investuar depozitat monetare.

19. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë Posta Shqiptare SHA të marrë masa për të hartuar dhe miratuar Rregulloren të posaçme për ndjekjen e procedurave dhe përcaktimin e dokumentacionit për depozitimin e mjeteve monetare në banka.

Menjëherë

- Rezultoi se komisioni i asgjësimit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe aktiveve qarkulluese për vitin 2012, nuk ka kryer procesin e asgjësimit fizik të materialeve jashtë përdorimit, në kundërshtim me afatet të përcaktuara në Urdhrin nr. 47, datë 13.09.2013 të Drejtorit të përgjithshëm.

20. Për këtë rekomandojmë që, të merren masa nga Posta Shqiptare SHA, për të kryer procesin e asgjësimit fizik të materialeve AAGJ dhe të aktiveve qarkulluese për të shmangur riciklimin e tyre dhe për të siguruar pasqyrimin real të tyre në bilanc, për materialet e vendosura për t'i nxjerrë jashtë përdorimit të konstatuara nga inventarizimi i kryer në vitin 2012, në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Brenda muajit qershor 2015

- Nga auditimi i kryer rezultoi se, nuk ka vendim nga Këshilli Mbikëqyrës për miratimin e rezultateve të inventarizimit të kryer në magazinën e pullave dhe letrave me vlerë për vitin 2013, veprim i cili bie ndesh nenet 14/8,9, dhe nenin 11/10 të statutit të shoqërisë. Po kështu, disa filiale kanë dërguar me vonesë për miratimin në Drejtorinë e financës dhe kontabilitetit, propozimet për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të konstatuara nga inventarizimi i aseteve të kryer për vitin 2013. Për drejtorët e këtyre filialeve, nga drejtoria e Postës Shqiptare SHA, nuk janë propozuar masa dhe për mungesa në dokumentacionin e inventarizimit të pasurisë të filialeve përkatëse, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011 dhe urdhrin e brendshëm të drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë.

- Grupi i punës i ngritur në Drejtorinë e përgjithshme të postës, nuk ka përgatitur relacionin përfundimtar mbi rezultatet e inventarizimit të pasurisë për vitin 2013, megjithëse ka përfunduar procesi i verifikimit fizik në terren nga grupet e inventarizimit nëpër filiale të postës.

- Nuk janë miratuar nga drejtori i përgjithshëm rezultatet e inventarizimit të pasurisë së postës shqiptare për vitin 2013, si dhe nuk ka nxjerrë urdhrin për ngritjen e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të propozuara nga filiale, në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011. Për pasojë, në kontabilitetin e shoqërisë dhe në bilancin kontabël të vitit ushtrimor 2013, nuk janë kryer veprimet kontabël për pasqyrimin e rezultateve të inventarizimit fizik të aseteve për vitin 2013, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

21. Për sa më lart rekomandojmë që, të merren masa nga Drejtoria e Postës Shqiptare për të përfunduar procesin e inventarizimit të aseteve të filialeve për vitin 2013, si dhe dega e financë dhe kontabilitetit të pasqyrojë rezultatet inventarizimit në kontabilitet, duke bërë asgjësimin e materialeve jashtë përdorimit, në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011.

Brenda muajit qershor 2015

- Nga auditimi i kryer deri në periudhën objekt auditimi rezultoi se, inventarizimi i pasurisë së filialeve për vitin 2014, dhe në veçanti inventarizimin fizik në Drejtorinë qendrore të Postës Shqiptare SHA, nuk ka filluar për arsye se, nuk ka përfunduar procedurat e plotë e inventarizimit të pasurisë së filialeve për vitin ushtrimor 2013.

22. Për këtë rekomandojmë që të merren masa nga Drejtoria e Postës Shqiptare, drejtorët e filialeve dhe grupet e punës të inventarizimit, për zbatimin e procedurave ligjore për inventarizimin e aseteve të shoqërisë për vitin 2014.

Brenda muajit qershor 2015

- Në disa filiale të Posta Shqiptare SHA, nuk janë realizuar të ardhurat nga shërbimi financiar dhe bankar për vitin 2013, si rezultat midis të tjerave, i mungesës në respektimin e rregullores për limitin e arkës në sportele, mungesës përgjegjshmërisë në shërbimet e kryera etj., si dhe

nga drejtuesit e filialeve nuk janë bërë rinovimet e marrëveshjeve me njësitë e qeverisjes vendore për zgjerimin e shërbimit të arkëtimit të faturave të ujit dhe me bankat e shoqëritë e kreditit për shërbimet bankare për arkëtim me këste kredie dhe për kryerje pagesash etj.

23. Për këtë rekomandojmë që Drejtoria e Postës Shqiptare të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë njësisë vartëse, si dhe zgjerimin e shërbimeve në sportelet postaret me qëllim realizimin e të ardhurave nga shërbimet financiare në të gjitha filialet e shoqërisë.

Vazhdimisht

- Për vitin 2013 dhe 2014 nuk është realizuar programimi i shërbimeve postare, kryesisht në shpërndarjen e faturave të OSHE-së e Albtelekomit SHA dhe pensione në shtëpi, duke mos realizuar të ardhurat për këto shërbime; si dhe janë zbatuar tarifatat sipas legjislacionit në fuqi, megjithëse nga shoqëria është propozuar rritja e tarifave të shërbimeve postare, akoma nuk janë miratuar nga Këshilli i Ministrave.

24. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e shoqërisë të analizojë në vijimësi veprimtarinë e këtij shërbimi, i cili përbën burimin bazë të të ardhurave të Postës, duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse në strukturat dhe njësitë vartëse, si dhe nëpërmjet ministrisë së linjës të insistojë në miratimin në një kohë sa më shpejtë nga Këshilli i Ministrave të tarifave përkatëse.

Brenda muajit qershor 2015

- Gjatë periudhës së auditimit ka tendencë në ulje të stokut të pullave ndër vite, por përsëri mbetet në vlera të larta e cila në fillim të vitit 2013 është në vlerën 35 milion lekë, si dhe janë prokuruar (prodhuar) pulla postare në numër dhe vlerë të krahasueshme me nevojat që ka shfaqur ky shërbim brenda dhe jashtë vendit.

25. Për këtë rekomandojmë që, Drejtoria e Posta Shqiptare SHA të hartojë dhe të zbatojë një program të veçantë masash për të ulur vazhdimisht stokun e pullës (qarkullimin e ngadalshëm të saj), duke kombinuar dhe përdorur prerje të ndryshme të saj në tarifatat e shërbimeve postare, gjatë kryerjes së shërbimeve postare.

Brenda muajit qershor 2015

- Për procedurën dhe kontratën “Rikonstruksion dhe shtesë katesh të godinës së administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Postave”, rezulton se:

- Nga Posta Shqiptare SHA nuk janë marrë masat për marrjen e lejes së ndërtimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, neni 70/1, “Detyrimi për aplikim për leje”;
- Projektit të zbatimit nuk i është bërë oponenca teknike, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 6;
- Mbikëqyrësi i punimeve ka filluar shërbimin e supervizionit pa nënshkruar më parë kontratën e shërbimeve konsulentë, si dhe pa zhvilluar prokurimin sipas ligjit, në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika I, 5. A;
- Megjithëse kontrata duhej të kishte përfunduar (pasi afat ka qenë për dy vjet), vetëm sa kanë filluar punimet, duke ndikuar negativisht në kushtet normale të punës së punonjësve, pasoja në mosrealizimin e investimeve, si dhe duke shkaktuar mundësinë e penalizimit të Postës për mosplotësimin e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë të kontraktuar për realizimin e punimeve civile të parashikuara.

26. Për sa më sipër rekomandojmë që, Posta Shqiptare SHA, të marrë masat e nevojshme për realizimin e procesit të oponencës teknike për projektin e rikonstruksionit dhe shtesë kati të godinës së administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Postave, duke bërë të mundur vazhdimin dhe realizimin sa më të kësaj kontrate.

Menjëherë

- *Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit rezultoi se:*

- Autoriteti kontraktor në rastin e dështimit të procedurës së prokurimit nuk ka kryer analizën për të evidentuar shkaqet e dështimit, si dhe në një rast ka ndërprerë (pezulluar) procedurën e prokurimit pa shkaqe të përligjura;
- Veprimtaria e autoritetit kontraktor për përcaktimin e fondit limit është formale, pasi nuk bazohet në analizë të thelluar të gjendjes së mallrave në magazinë, konsumit të vitit të mëparshëm, kërkesave analitike të strukturave vartëse dhe perspektivën e zhvillimit të shoqërisë, duke sjellë si pasojë prokurime mbi nevojat e saj për shtypshkrime në vitin 2013 rreth 9.9 milion lekë dhe në vitin 2014 rreth 10.7 milion lekë, ndërsa për kancelari në vitin 2013 mbi nevojat afër 4.9 milion lekë, si dhe duke krijuar mallra me qarkullim të ngadalshëm dhe stok që cenojnë ecurinë e zhvillimit të shoqërisë;
- Në rastin e kontratës “Sisteme alarmi, vëzhgimi dhe shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të alarmit e të vëzhgimit, marrjes në rrugë valore të sinjaleve të alarmit, verifikimit në grup të gatshme ne te gjitha filialet dhe degët postës shqiptare dhe shërbimi me GPS/GPRS (Global Positioning System/General Packet Radio Service) për automjetet e saja” 2013, është pezulluar dhe rritur fondit limit pa shkaqe të përligjura në vlerën 3,990,699 lekë;
- Hartimi i specifikimeve teknike për procedura të ndryshme prokurimi nuk kryhet nga struktura të specializuara për objektin e tenderimit, duke sjellë pasoja në hartimin e dokumenteve nga operatorët, si dhe vështirësi të KVO për kualifikimin dhe shpalljen e fituesit;
- Në disa raste, Njësia prokurimit nuk ka përcaktuar paraqitjen e katalogëve dhe manualeve të përdorimit për pajisje të përkthyer apo nuk ka vendosur kufij monetar të xhiros vjetore dhe mangësi në vendosjen e kapacitetit teknik jo në raport me objektin e kontratës;
- Në disa raste KVO nuk ka anëtarë pjesëmarrës specialistë të fushës objekt prokurimi; ka subjektivizëm dhe interpretime të kriterëve të kualifikimit gjë që mund të cenojë procesin e përzgjedhjes së fituesit, si dhe nuk është kërkuar në asnjë rast ndihma e organeve tatimore për verifikimin e faturave të ndryshme (kryesisht midis vetë subjekteve);
- Në komisionet e kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim nuk është përfshirë asnjëherë personi me përgjegjësi materiale, si dhe në përbërjen e tyre nuk kanë qenë specialistë të fushës objekt kontrate;
- Nga veprimet e papërgjegjshme të komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave të kontratës “Blerje projekte dhe materiale promocionale 2013” janë pranuar mallra jo sipas specifikimeve teknike në vlerën 854,700 lekë, e cila është dëm ekonomik për shoqërinë;
- Nga veprimet dhe mosveprimet e komisionit të marrjes në dorëzim dhe kolaudimit për mallrat e kontratës “Blerje shtypshkrime 2014”, ka rezultuar mungesë fizike malli në vlerën 2,562,933 lekë të cilat përbëjnë dëm ekonomik për shoqërinë;
- Në rastin e zbatimit të kontratës “Blerje pajisje rrjeti DC, për shpërndarjen e internetit për implementimin e sistemit DWDM” nga Interpost SHPK, me zgjatjen e afatit të kontratës pa shkaqe të përligjura është shmangur penalizmi i kontraktorit në shumën 9,489,211 lekë; është kryer pagesa me vonesë 5 - 7 muaj i kontratës, mbi bazën e mallrave të pa kolauduara dhe të atestuara, si dhe të pa dokumentuara me flete-hyrje të magazinës; si dhe një pjesë e mallrave nuk janë vendosur për shkak të mungesës së investimeve nga institucione të tjera, duke e bërë këtë kontratë të dështuar pjesërisht;
- Në rastin e kontratës “Blerje shtypshkrime 2014” janë bërë hyrje dhe dalje, si dhe i janë kryer pagesa kontraktorit pa ardhur fizikisht malli në magazinë, i pa kolauduar si dhe me diferenca për artikujt e ambalazhuar;
- Në dy raste janë kryer shtesa kontrate pa shkaqe të përligjura të kushteve të emergjencës, por si rezultat i neglizhencës së autoritetit kontraktor në fillimin me kohë të procedurave normale të procedurës së prokurimit;
- Në një rast të procedurës së prokurimit është përzgjedhur operatori me vlerë më të lartë me diferencë 61,900 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë;

- Në dy raste janë përdorur emërtime markash në blerjet me vlera të vogla 2013, si dhe në një rast janë përdorë brenda vitit për të njëjtin artikull procedura blerje me vlera të vogla dhe tender i hapur, duke e konsideruar copëzim të fondeve.

27. Për sa më sipër rekomandojmë që, Autoriteti kontraktor të marrë masa të menjëhershme për shmangien e mangësive të evidentuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit, duke ndjekur nga afër të gjithë ciklin e prokurimit, me një monitorim rigoroz të kuadrit ligjor të prokurimeve dhe të menaxhimit financiar në njësitë publike.

Vazhdimisht

- Në vitin 2014, Posta shqiptare Sha ka ulur nivelin e auditimit të brendshëm në Filiale, duke hequr audituesit e filialeve, me përjashtim të Tiranës, si dhe në vitin 2013 nuk janë realizuar auditimet e planifikuara nga audituesit e filialit Elbasan dhe Korçë, si dhe në vitin 2014 nga njësia e auditimit në Filialin e Postës Tiranës nuk është realizuar programi për 18 auditime të plota dhe të pjesshme;

- Në një pjesë të konsiderueshme të gjetjeve të auditimit, ka përsëritje të tyre nga njëri auditim në tjetrin, gjë që reflektohet edhe nga butësia e masave disiplinore të rekomanduara dhe të zbatuara, si dhe auditimet e kryera vazhdojnë të jenë të tipit tradicional, duke mos pasur akoma auditime specifike në nivel sistemi (p.sh. zbatimi i aktmarrëveshjeve me OSHEE, ISSH etj; administrimi i pagave dhe numri i punonjësve etj.) dhe të performancës (programi ekonomik dhe financiar, burimeve njerëzore, sistemi i prokurimeve etj.)

- Në programin e auditimeve vazhdon të mos përfshihet drejtoria e përgjithshme e postës, në të cilën është përqendruar kryerja e procedurave të prokurimit për investime dhe shpenzime, marrëdhëniet ekonomike dhe financiare me filialet dhe të tretët etj.

28. Për sa më sipër rekomandojmë që, Këshilli mbikëqyrës dhe Drejtoria e Postës Shqiptare, të rishikojnë vendimin për uljen e nivelit të auditimit të brendshëm në filiale, duke analizuar me hollësi jo vetëm në kuadër të rezultatit kosto-përfitim, por edhe të gjetjeve të auditimit dhe domosdoshmërisë së kontrollit të vazhdueshëm deri në nivelin e zyrave dhe agjentëve postar;

Brenda muajit qershor 2015

- **Të marrë në analizë dhe të evidentojë përgjegjësitë e drejtuesit të filialit Tiranë për mos realizimin e programit të auditimeve, si dhe të kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme informacione mbi ecurinë e programit dhe të rezultateve të auditimit;**

- **Të kërkojë nga Drejtoria e auditimit forcimin dhe thellimin e masave disiplinore dhe administrative ndaj personave përgjegjës të evidentuar nga rezultatet e auditimit me mangësi dhe probleme;**

- **Të kërkojnë nga Drejtoria e auditimit që duke filluar nga ky vit të shtojnë në programet e tyre edhe auditimet e sistemeve dhe auditimet e performancës, duke rritur efikasitetin e veprimtarisë audituese, si dhe të përfshijë dhe Drejtorinë e përgjithshme (sektor dhe degë të veçanta) nën auditimin e brendshëm.**

Vazhdimisht

- **Gjatë auditimit të Filialit të Transittit.**

- Drejtori i filialit ka marrë aktive materiale afatgjata të njësisë publike, sasinë e hekurit prej 2,748 kg dhe vlerë tregu 96,180 lekë, pa zbatuar asnjë lloj rregulli dhe procedure ligjore;

- Janë shpenzuar për monitorimin e linjave dieta për shërbime jashtë qendrës së punës brenda vendit dhe karburant për automjete në dispozicion në vlerën 1,734,630 lekë, pa pasur asnjë gjurmë mbi rezultatet e tyre, në një kohë që lëvizja e automjeteve monitorohet me sistem elektronik satelitor dhe gjendja e rrugëve e cilësia e kryerjes së shërbimit mund dhe duhej të kryhej nga specialistët e filialit duke përdorur linjën me shoferin përkatës;

- Në administrimin e marrëdhënieve të punës të filialit, nuk janë zbatuar Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 56, datë 29.10.2013 “Mbi procedurën paraprake që do të ndiqet për vlerësimin

e përputhshmërisë së fuqisë punëtore me pozicionin e punës, pranë filialeve të Posta Shqiptare Sha, përpara emërimit në detyrë” dhe nr. 59, datë 01.11.2013 “Mbi procedurën paraprake që do të ndiqet për transferimet/lëvizjet paralele apo shkarkimet e fuqisë punëtore pranë filialeve të Posta Shqiptare Sha”.

29. Për sa më sipër rekomandojmë që Filiali i Transistit:

- Të përcaktojë procedurat përkatëse për rastet e kryerjes së mirëmbajtjeve të ndryshme në ambientet dhe asetet e Filialit, duke përcaktuar përgjegjësitë e secilit punonjës të stafit, që nga hartimi i preventivit dhe deri tek situacioni i punimeve të kryera, me synim mirë menaxhimin e aktiveve të njësive publike;
- Të miratojë rregulla specifike dhe procedurat përkatëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011;
- Të shmangë kryerjen e shpenzimeve pa efektivitet për monitorimin e linjave, me synim zvogëlimin e humbjeve të filialit dhe rritjen e fitimit të shoqërisë Posta Shqiptare;
- Të sistemojë gjithë dokumentacionin e emërtesës fuqi punëtore dhe personelit të Filialit të Transistit, në përputhje me Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 56, datë 29.10.2013 dhe nr. 59, datë 01.11.2013 për vlerësimin e përputhshmërisë së fuqisë punëtore me pozicionin e punës, si dhe për transferimet/lëvizjet paralele apo shkarkimet së fuqisë punëtore pranë filialeve të Posta Shqiptare Sha.

Brenda muajit qershor 2015

Nga auditimi në Filialin e Shkodrës:

- Rregullorja e brendshme e filialit është e datës 08.06.2010, duke pasur mospërputhje me ndryshimet organizative të vendosura nga këshilli mbikëqyrës në mars të vitit 2014;
- Në 9 mujorin 2014 të ardhurat kanë qenë programuar 100,687 mijë lekë dhe janë realizuar 96,905 lekë, pra me një mosrealizim prej 3,782 mijë lekë, por që në fund të vitit janë realizuar dhe tejkaluar të ardhurat e programuara;
- Nga vlera gjithsej kontabile e aseteve ndërtesa prej 74,695,202 lekë, janë në proces të marrjes së certifikatës hipotekore 3,584,579 lekë ose 8 objekte postare nga 42 objekte gjithsej;
- Gjendja ditore e arkës vendosur prej 30 milion lekë, përgjithësisht nuk respektohet, si rezultat i fluksit të pagesave në fillim të muajit si dhe nevojave fillestare të ditës punës krahasuar me orarin e fillimit të punës në banka;

30. Për sa më sipër rekomandojmë që Filialit të Postës Shkodër:

- Të marrë masa të menjëhershme për rishikimin dhe ndryshimin e Rregullores së brendshme në përputhje me strukturën organizative aktuale, në funksion të rritjes së përgjegjësisë dhe performancës së secilit punonjës të shoqërisë;
- Të miratojë rregulla specifike dhe procedurat përkatëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011.

Menjëherë

- Të marrë masa për përfundimin e regjistrimit ligjor (marrjes së certifikatës hipotekare) edhe për 8 objektet postare të mbetura që rezultojnë në proces;

Brenda vitit 2015

- Të kryejë analiza periodike dhe të veçanta të ecurisë së treguesve ekonomik dhe financiar, duke evidentuar përgjegjësitë e stafit dhe të personelit, me qëllim që të sigurohet realizimi programit të zhvillimit të filialit;
- Të bëjë përpjekjet maksimale për të mbajtur, ruajtur dhe siguruar limitin ditor të arkës, duke harmonizuar nevojat dhe shpërndarjen ditore, kohën dhe sigurinë e vazhdueshme fizike të vlerave monetare.

Vazhdimisht

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

- Drejtoria e Postës Shqiptare nuk ka kryer arkëtimin e shpenzimeve mbi kufirin e përcaktuar ligjor të telefonisë celulare, duke i kaluar në shpenzime të shoqërisë për pesë persona, të rekomanduar gjatë auditimit të mëparshëm.

1. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e detyrimit të shpenzimeve në vlerën 102,569 lekë për pesë persona për përfitim të padrejtë të shpenzimeve telefonike.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 23 të Raportit Përfundimtar)

- Drejtoria e Postës Shqiptare, me dy vendime ka kaluar në shpenzime të shoqërisë, tejkalimin e shpenzimeve telefonike për dy drejtues të lartë të shoqërisë në mënyrë të pabazuar ligjorisht.

2. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e detyrimit të shpenzimeve në vlerën 168,246 lekë për dy persona për përfitim të padrejtë të shpenzimeve të telefonisë celulare.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 30 të Raportit Përfundimtar)

- Është likuiduar subjekti, me vlerën prej 478,800 lekë, mbi bazën e procedurës së prokurimit me vlera të vogla, për shërbimin e diagnostikimit të situatës manaxhuese. Sipas dokumenteve të vëna dispozicion, ftesa për ofertë është bërë me datën 27.11.2013; sipas faqes elektronike ofertat e dy subjekteve janë paraqitur me datën 27.12.2013 dhe kontrata është lidhur me datën 10.12.2013, pra para se të dalë rezultati i fituesit nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla. Si dokument justifikues për likuidim nga subjekti është paraqitur vetëm fatura nr. 3370 e datës 23.12.2013, duke mos pasur material bashkëlidhur likuidimit për shërbimin e kryer. Sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 1.2 e kontratës, likuidimi duhej të bëhej brenda 10 ditëve të lidhjes së kontratës. Nuk ka akt-rakordim nga dy palët për shërbimin e kryer, e përcaktuar në nenin 3 pika 2.3, pra është paguar pa realizuar shërbimin sipas kontratës.

3. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës prej 478,800 lekë përfituar padrejtësisht nga Subjekti, për shërbim të paprovuar të kryer sipas kontratës.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 44 të Raportit Përfundimtar)

- Është paguar servis, vlera prej 388,800 lekë për riparim automjeti, si rast emergjence. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla ka hartuar procesverbalin e datës 06.02.2014, si rast urgjent për defektin e pësuar automjeti në përdorim të Drejtorit të Përgjithshëm. Me datën 03.02.2014 është mbajtur procesverbal nga grupi i punës dërguar në vendin e defektit të automjetit, ku thuhet, se automjeti me datën 31.01.2014 në kthim nga Rinasi pësoi defekt pasi u fik motori. Grupi i punës nuk ka përshkruar shkaktuesin pse automjeti ishte në Rinas, në një kohë që Drejtori Përgjithshëm me datën 01.02.2014 kthehej nga Boston, që ishte me shërbim. Procesverbali i komisionit të blerjeve të vogla përshkruan se nevoja e riparimit ndodhi me datën 03.02.2014, në orën 15 e 30 minuta.

4. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës 388,800 lekë, të shpenzuara në mënyrë të pabazuar ligjorisht, të cilat përbejnë dëm ekonomik për shoqërinë.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 44 të Raportit Përfundimtar)

- Në rastin e tenderit për fushatë publicitare për vitin 2013 është lidhur kontratë me subjektin....., në pikën 1.2 të së cilës përcaktohet se: “Agjencia merr përsipër të sigurojë prodhimin e 2 spoteve të rinj televiziv, 1 spot radiofonik dhe layout e gazetave”, kështu paraqitja e çmimeve për këto prodhime nuk është pasqyruar për secilin element në vete, por në

total; nuk përshkruhet se çfarë janë spotet e reja që do të prodhohen nga subjektet që të krahasohej cilësia dhe përmbajtja e tyre. Sipas raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni i vlerësimit, ka përshkruar dokumentacionin e secilit subjekt pjesëmarrës dhe çmimin, duke shpallur fitues çmimin më të ulët, pa përshkruar se çfarë janë spotet e reja që do të prodhohen nga subjektet që të krahasohej cilësia dhe përmbajtja e tyre dhe jo vetëm çmimi në total i cili paraqitet me një vlerë prej 1,775,000 lekë nga subjekti, me vlerë 1,777,000 lekë nga subjekti, pra me diferenca të vogla, duke të çuar në dyshimin e arsyeshëm se subjekti fitues ka qenë paracaktuar.

5. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës 1,765,000 lekë nga subjekti, përfituar padrejtësisht nga kontrata e fushatës publicitare 2013.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 44-48 të Raportit Përfundimtar)

- Këshilli Mbikëqyrës, gjatë vitit 2012 është shpërblyer për rezultate në punë, me kërkesë dhe vendim të Drejtorisë së Posta shqiptare nr 553, date 04.03.2013, si dhe të miratuar në METE me shkresën nr. 2321/1, datë 09.05.2013 në shumën totale prej 888,000 lekë nga secili prej 6 anëtarë të tij, në interpretim të gabuar të ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” neni 160, 166 dhe 167.

6. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës prej 888,000 lekë përfituar padrejtësisht nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318 datë 08.04.2009 “Për emërimin dhe funksionimin e këshillave mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore” kreu V pika 3.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 51 të Raportit Përfundimtar)

- Anëtarët e drejtorisë kanë marrë në vitin 2013 shpërblim për leje vjetore të pa marra në dy vite paraardhëse në kundërshtim me kuadrin përkatës ligjor.

7. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës prej 791,590 lekë përfituar padrejtësisht nga 5 ish anëtarë të drejtorisë për leje vjetore të pa marra, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 i ndryshuar, kreu II pika 2.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 52 të Raportit Përfundimtar)

- Kontrata e lidhur me Raiffeisen Bank për depozitën e shumës 13,847,342.82 lekë, me afat maturimi 6 mujor, rezulton se është lidhur me normë interesi 4.7 %, kur vendimi i drejtorisë me nr. 120, datë 23.04.2012, ka miratuar normë interesi në masën 6.5 %. Diferenca në masën 1.8 % më e ulët, midis normës së interesit të miratuar nga drejtoria dhe normës së interesit të aplikuar nga banka në zbatim të kontratës ka sjellë si pasojë një dëm ekonomik për shoqërinë.

8. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës prej 249,252 lek nga z....., për nënshkrim kontrate me normë interesi më të ulët nga vendimi i drejtorisë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 75-76 të Raportit Përfundimtar)

- Në procedurën e prokurimit “Blerje zarfe për shërbimin postar” 2013, KVO ka skualifikuar një operator pasi: në mostrat e zarfeve të paraqitur rezultojnë: a-secila nga mostrat e paraqitura të zarfeve, janë të pa vulosura nga operatori ofertues; b- në vend të zarfit të vogël me përmasa 11 x 23 cm është paraqitur një mostër Zarfi me dimensione të ndryshme nga specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, shtojca 8, pa i vlerësuar si devijime të vogla, pasi vlera e përcaktuar në fondin limit për zarfet 11x23 cm ka qenë planifikuar 90,000 lekë dhe diferenca midis këtij ofertuesi dhe të shpallurit fitues ishte 776,840 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

9. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës prej 776,840 lekë nga z....., zj. dhe z....., për dëmin e shkaktuar shoqërisë nga mangësitë në kualifikimin e operatorit fitues.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 101-103 të Raportit Përfundimtar)

- Nga verifikimi i mallrave të mundshëm të furnizuara nga subjekti në zbatim të kontratës “Blerje projekte dhe materiale promocionale” 2013, rezulton se për artikullin “Axxhenda 2014” me sasi 1000 copë dhe vlerë 817,200 lekë (me TVSH) nuk është në përputhje me specifikimet teknike, pasi nuk është axhendë me mekanizëm por i lidhur në formë libri; nuk e ka mbulesën me ngjyre blu por gri, si dhe nuk ka stilolaps të brenduar anash; si dhe 5,000 kartolinat e prodhuara me vlerë 37,500 lekë nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara, pasi nuk janë të printuara në dy anët, si dhe nuk janë deri në 5 modele të ndryshme.

10. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës 822,200 lekë nga subjekti....., për mallra të dorëzuara jo sipas specifikimeve teknike.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 111-112 të Raportit Përfundimtar)

- Në procedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për faqe interneti Interpost 2013, është kualifikuar oferta me vlerën më të madhe prej 241,900 lekë në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu VI, pika 2, shkronja “c” në të cilën përcaktohet se “Bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, komisioni përcakton fituesin”.

11. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës 61,900 lekë nga z....., z. dhe z.

për kualifikim dhe shpallje fitues të subjektit me vlerën më të lartë, duke shkaktuar dëm ekonomik për shoqërinë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 116-117 të Raportit Përfundimtar)

- Gjatë zbatimit të kontratës “Blerje shtypshkrime” 2014, sipas sondazheve të kryera nga grupi i auditimit të brendshëm të Postës në disa filiale (Tiranë, Lushnjë, Fier, Durrës, Burrel, Shkodër, Lezhë etj.) për Letër për sportelet e shërbimit me kanë rezultuar diferenca të mëdha të sasisë faktike në kuti dhe sasisë së cilësuar në etiketë. Në këtë mënyrë vlerësohet të mungojnë fletë në vlerë 2,562,933 lekë; deri me datën 30.11.2014, kontraktori ka kryer 33 % të furnizimeve gjithsej të kontratës, çka do të thotë se në zbatim të nenit 7 të kontratës, duhet të penalizohet me 13,191,033 lekë për vonesa në plotësimin e detyrimeve kontraktore.

12. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës 15,753,966 lekë nga subjekti....., për diferenca në furnizimin e mallit dhe penalizmi për vonesa në mosplotësimin e kushteve kontraktore.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 119-128 të Raportit Përfundimtar)

- Me datën 01.07.2014, me fletë-daljen nr. 472, magazinieri i Filialit të Transitit ka bërë dalje sasinë prej 2,748 kg hekur dopio me vlerën e tregut 96,180 lekë (35 lekë/kg) dhe nga verifikimi në terren rezulton se nuk është përdorur në territorin e këtij filiali. Sipas një procesverbali të datës 02.07.2014, me sponsorizimin e drejtorit u morën mjetet përkatëse makinë me vinç dhe u transportuan shufrat e hekurit jashtë si mbeturina bashkë me pjesë makinash të prishura, të cilat u hoqën jashtë orarit të punës.

13. Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e shoqërisë të marrë masat përkatëse ligjore për arkëtimin e shumës 96,180 lekë nga z....., pasi ka marrë aktive materiale afatgjata të njësisë publike, sasinë e hekurit prej 2,748 kg pa zbatuar asnjë lloj rregulli dhe procedure.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 138-141 të Raportit Përfundimtar)

C. MASA DISIPLINORE

Bazuar në Kontratën kolektive të punës, nënshkruar me 19.03.2013 ndërmjet “Posta Shqiptare” SHA dhe sindikatës së punonjësve të Postë-Telekomit, neni 21, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

“Largim nga detyra”, për:

1. **Z.....**, në cilësinë e Drejtorit të Filialit të Transistit, pasi: ka marrë aktive materiale afatgjata të njësisë publike, sasinë e hekurit prej 2,748 kg dhe vlerë tregu 96,180 lekë, pa zbatuar asnjë lloj rregulli dhe procedure në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 8, pika 1;

- Me veprimet dhe mosveprimet e tij, nëpërmjet keq menaxhimit të shpenzimeve operative për monitorimin e linjave, ka rritur humbjen e Filialit për 1,734,630 lekë kosto të panevojshme, duke ulur fitimin e shoqërisë Posta Shqiptare SHA dhe për pasojë detyrimet fiskale në buxhet, në një kohë që lëvizja e automjeteve monitorohet me sistem elektronik satelitor dhe gjendja e rrugëve e cilësia e kryerjes së shërbimit mund dhe duhej të kryhej nga specialistët e filialit duke përdorur linjën me shoferin përkatës, si dhe janë keqadministruar burimet njerëzore në dispozicion duke i angazhuar në mënyrë prioritare pjesën më të madhe të kohës së punës në detyra jashtë përcaktimeve funksionale, duke ulur performancën e tyre dhe për pasojë edhe atë të Filialit;

- Nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 56 datë 29.10.2013 “Mbi procedurën paraprake që do të ndiqet për vlerësimin e përputhshmërisë së fuqisë punëtore me pozicionin e punës, pranë filialeve të Posta Shqiptare SHA, përpara emërimit në detyrë” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 59 datë 01.11.2013 “Mbi procedurën paraprake që do të ndiqet për transferimet/lëvizjet paralele apo shkarkimet së fuqisë punëtore pranë filialeve të Posta Shqiptare SHA”, duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren e brendshme të Filialit, pika 9, të cilat në rastin e largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme shkaktojnë penalizimin e shoqërisë, po ashtu emërimet provizore si dhe lëvizjet e shpeshta të fuqisë punëtore influencojnë në performancën e filialit.

2. **Zj.....**, në cilësinë e Drejtores së Administrimit të Përgjithshëm, pasi ka hartuar dhe dërguar mbi 5 muaj me vonësë programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 315, datë 08.04.2009;

- Në 9-mujorin 2014 është tejkaluar numri mesatar i punonjësve me 12 persona dhe nuk është realizuar fondi i pagave, duke demonstruar mangësi në programim dhe realizimin e treguesve të punës dhe performancën e punonjësve;

- Në cilësinë e anëtares së Komisionit të blerjeve me vlera të vogla, në 4 raste me vlerë gjithsej 1,621 mijë lekë, bashkëlidhur me dokumentacionin e bankës nuk janë kërkesat nga sektorët për nevojat e blerjes ose kryerjes së këtij shërbimeve të miratuara nga kjo Drejtori, si dhe nuk ka asnjë procesverbal për vendosjen e materialeve të blera; është paguar servisvlera prej 388,800 lekë për riparim automjeti, si rast emergjence, sipas procesverbalit me datë 06.02.2014, si rast urgjent, për defektin e pësuar automjeti i Drejtorit të Përgjithshëm dhe me datën 03.02.2014 është mbajtur procesverbal nga grupi i punës dërguar në vendin e defektit të automjetit, në të cilën përcaktohet se, automjeti me datën 31.01.2014 në kthim nga Rinasi pësoi defekt pasi u fik motori. Nuk është analizuar se, pse automjeti ishte në Rinasi kur Drejtori Përgjithshëm me datën 01.02.2014 kthehej nga Boston, që ishte me shërbim, si dhe Procesverbali i komisionit të blerjeve të vogla, përshkruan se nevoja e riparimit ndodhi me datën 03.02.2014, në orën 15 e 30 minuta.

3.

4.

5....., pasi: në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim të mallit për kontratën “Blerje shtypshkrime” 2014, me nr. 749/8 prot., datë 09.06.2014 lidhur me.....

- Në pasqyrim të aktivitetit të tyre kanë evidentuar midis të tjerave, aktin e kolaudimit datë 17.06.2014 për 11 artikuj, cilësohet që “Pas verifikimeve, komisioni arriti në përfundimin se malli rezultoi sipas specifikimeve teknike të pasqyruara në kontratë”, të cilat sipas aktit të marrjes në dorëzim janë sipas faturës tatimore me TVSH të kontraktorit nr. 163, datë 17.06.2014, dhe fletë hyrjes tatimore me nr. serie 036575, pa numër rendor të datës 17.06.2014 të pa firmosur nga blerësi.

Sipas dokumenteve vërtetues të magazinës: fletëdalje të furnitorit dhe fletëhyrje të magazinës së Posta Shqiptare SHA, rezultoi se deri me datën 17.06.2014 kanë qenë fizikisht në magazinë pesë artikuj. Nga krahasimi i aktit të kolaudimit dhe aktit të marrjes në dorëzim të komisionit të kolaudimit që shoqëron faturën me TVSH të furnitorit e datës 17.06.2014 me dokumentet vërtetues të magazinës deri në këtë periudhë, rezultoi si më poshtë:

- Etiketa RRAA: në magazinë fizikisht 598,431 copë dhe 19 rulona, në akt-kolaudim dhe aktin e marrjes në dorëzim 2,530,000 copë, pra 1.9 milion copë të paqena fizikisht;
- Etiketa RRAL në magazinë 111,560 copë, në akt-kolaudim dhe aktin e marrjes në dorëzim janë 1,120,000 copë, pra 1.1 milion copë të paqena fizikisht;
- Etiketa E4/2 copë 200,000 në magazinë dhe 200,000 të kolauduara dhe të marra në dorëzim;
- Modeli P3 e re, në magazinë 1,900 copë, të kolauduara 7,000 copë, pra 5,100 copë të paqena fizikisht;
- Model P1, fizikisht në magazinë 200,000 copë, të kolauduara dhe të marra në dorëzim nga komisioni 480,000 copë, pra 280,000 copë më shumë të paqena fizikisht, si dhe nuk kanë ardhur fizikisht në magazinën qendrore të postës 6 artikuj të tjerë.

Si përfundim rezultoi se fizikisht në magazinë ka ardhur malli me vlerë 17 % e faturës së shitësit, si dhe kolaudimi nuk është bërë për mallin fizik, por formalisht dhe fiktivisht për faturën. Në këtë mënyrë, komisioni i kolaudimit ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42, në të cilën përcaktohet “*Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues*”, nuk janë shprehur për dokumentacionin shoqërues.

- Sipas dokumenteve të tenderit, shtojca 8- Specifikimet teknike, një pjesë e artikujve duhej të dorëzoheshin të pakëtuara, p.sh. Etiketa CN e kuqe 1,000 copë pako; etiketa EN RRAA në rulona me nga 1,000 copë; letër për portalin e pagesave A4 në kuti me 700 fije; letër për portalin e pagesave A5 në kuti me 1,400 fije etj. Sipas verifikimit në magazinën e qendrës të Postës Shqiptare këto dy të fundit kanë ardhur me kuti të mbyllura me shënimin 670, 700, 1000, 1400, 2000 copë. Duke mos ju përmbajtur specifikimeve teknike, por duke shënuar direkt sasinë artikujve respektive, komisioni i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim ka marrë përsipër saktësinë e sasive përkatëse dhe mos pasqyrimi i tyre demonstroi se procesi ka qenë formal.

Nga verifikimi i kryer prej auditit brendshëm të Postës Shqiptare për artikujt:- letër traktor A4 dhe etiketa kodbar RR AA (9 numra) kanë rezultuar diferenca të mëdha krahasuar me etiketat e ambalazhimit të mallit. Sipas sondazheve të kryera nga grupi i auditimit në disa filiale (Tiranë, Lushnjë, Fier, Durrës, Burrel, Shkodër, Lezhë etj.) për Letër për sportelet e shërbimit me “Eternen” A4 kanë rezultuar diferenca të mëdha të sasisë faktike në kuti dhe sasisë së cilësuar në etiketë. Në këtë mënyrë nga 96 kuti që duhet të përmbanin sipas etiketës 95,600 fletë letër për sportelet, në fakt kanë patur më pak 30,235 copë, të vlerësuar në lekë 135,368 lekë ($30,235 \times 3.731 = 112,807 \times 1.2$). Numri i fletëve që rezultojnë mangut përbën 31.6% të sasisë së fletëve që duhej të ishin në kuti, duke pasur parasysh që sipas dokumenteve të financës deri më

30.10.2014, Posta është furnizuar me 2,172,000 fletë dhe mbi bazë e kësaj përqindjeje të fletëve mangut, vlerësohet të mungojnë fletë në vlerë 2,562,933 lekë, duke e konsideruar dëm ekonomik për shoqërinë dhe duke ngarkuar me përgjegjësi indirekte komisionin e kolaudimit. Gjithashtu, nuk provohet nga ana e komisionit të kolaudimit cilësia sipas specifikimeve teknike të DT (shtojca 8) dhe të paraqitura nga ofertuesi fitues....., lidhur me peshën e letrës, bardhësinë e saj, përmasat e dokumenteve, pesha e letrës së mbështjelljes së blloqeve, shtypja në dy anët ose nga njëra anë, ngjyra e shkrimit etj.

Në këtë mënyrë, rezulton se komisioni i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, pika 5.3 dhe 6.A.7 të kontratës, sipas së cilës malli që nuk është në sasi dhe sipas specifikimeve të kërkuara në DST dhe të pranuar në ofertë nga kontraktuesi, nuk do të pranohet, duke shkaktuar dëm ekonomik me pasoja të mëdha për shoqërinë.

Bazuar në sa më sipër, argumentohet se veprimtaria e Komisionit të kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të mallit për këtë kontratë ka qenë fiktivë, duke mos evidentuar sasinë dhe cilësinë sipas specifikimeve teknike në kontratë, me pasoja të mëdha ekonomike dhe financiare për shoqërinë, për të cilat mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë ky komision.

Theksojmë se sipas deklarimeve të magazinieres së Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare, në marrjen në dorëzim të mallit nuk ka qenë i pranishëm pothuajse asnjëherë komisioni i marrjes në dorëzim të shtypshkrimeve.

Grupi i kolaudimit dhe i marrjes në dorëzim dhe përfaqësuesi i kontraktorit....., kanë mbajtur një procesverbal më datë 15.10.2014, sipas të cilit: “Grupi i marrjes në dorëzim u thërrit për kolaudim malli që i përket faturës me nr. 325, datë 15.10.2014 me vlerë 8,119,850 lekë, sipas magazinieres është futur në magazinë që në muajin korrik. Pra sipas magazinieres në datën 15.10.2014 firma ka sjellë faturën e këtij malli me nr. 325, datë 15.10.2014. Për sa më sipër grupi i kolaudimit dhe i marrjes në dorëzim nuk mund të kolaudoj një mall që nuk është prezent për t’u dorëzuar nga firma kontraktore”. Kjo do të thotë se nga furnizimet gjithsej të likuiduara prej 21,775,620 lekë, 37 % e kësaj nuk janë kolauduar dhe marrë në dorëzim rregullisht nga komisioni përkatës.

6. në cilësinë anëtarit të komisionit të kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të mallrave, pasi: Me urdhrin e brendshëm të Administratorit të Interposta SHPK nr. 19, datë 05.09.2012 është caktuar në grupin e punës së marrjes në dorëzim, testimin dhe monitorimin për mallrat objekt i kontratës “Blerje pajisje rrjeti DC, për shpërndarjen e internetit për implementimin e sistemit DWDM”. Nga auditimi ka rezultuar me mangësi procesi i marrjes në dorëzim dhe testimi si dhe nuk është kryer monitorimi i saj:

- Akti i marrjes në dorëzim i datës 07.11.2012 për 40 artikuj me nënshkrimet përkatëse, si dhe vula dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të firmës....., në fillim të të cilit theksohet se komisioni punoi për marrjen në dorëzim të mallit sipas sasive përkatëse. Mallrat e marra në dorëzim duhet t’i përkasin faturave nr. 234 dhe 235 të datës 31.10.2012 të cilat përmbajnë 60 artikuj të koduar, të cilët kanë ardhur në doganën shqiptare në datën 06 dhe 07.11.2012. Nga kjo rezulton se nuk janë marrë në dorëzim analitikisht 20 artikuj të koduar që ju përkasin këtyre faturave, si dhe pa referencën për numrin dhe datën e faturës, gjë që krijon mundësinë të dyshohet mbi kryerjen e procesit të marrjes në dorëzim. Ky akt i marrjes në dorëzim nuk është shoqëruar me kolaudimin e tyre.

- Në dosje ndodhej Akti i marrjes në dorëzim i datës 17.11.2012 për 31 artikuj të koduar, të cilët duhet të korrespondojnë me faturën e shitësit nr. 234 dhe 235 të datës 31.10.2012, të cilët kanë ardhur në Shqipëri me datë 06 dhe 07.11.2012, pra Komisioni i ka marrë në dorëzim mallin e të njëjtave fatura në sasi dhe kohë të ndryshme. Ky akt i marrjes në dorëzim është nënshkruar nga komisioni, si dhe është pa vulën dhe nënshkrimin e përfaqësuesit të firmës shitëse, pa përcaktuar vendin e kryerjes së marrjes në dorëzim, si dhe pa referencën për numrin dhe datën e faturës, duke demonstruar për një proces fiktiv të marrjes në dorëzim. Në dosje ndodhej dhe akti kolaudimit po në këtë datë pa vulën dhe nënshkrimin e përfaqësuesit të firmës

shitëse, pa përcaktuar vendin e kryerjes së marrjes në dorëzim, si dhe pa referencën për numrin dhe datën e faturës,

- Me observacione kanë sjellë kopje të Aktit të marrjes në dorëzim të datës 17.11.2012 për 40 artikuj të koduar, të cilët duhet t'i përkasin faturave 234 dhe 235 të datës 31.10.2012 të cilët përmbajnë 60 artikuj të koduar, pra nuk janë kolauduar 20 artikuj. Po ashtu dhe aktin e kolaudimit të datës 17.11.2012, në tekstin e fillimit të këtij dokumenti, nuk ndryshon nga akti i marrjes në dorëzim: "Komisioni punoi për marrjen në dorëzim të mallit sipas sasive të mëposhtme, duke u bazuar në kontratën nr. 44/10 prot., datë 05.09.2012 ndërmjetdhe....., pra nuk është një dokument kolaudimi, aq më tepër që janë pajisje elektronike, testimi i të cilave kërkon instalimin dhe vënien në funksion të tyre. Te dy dokumentet janë nënshkruar nga komisioni i kolaudimit dhe përfaqësuesit i firmës....."

- Me observacionin e datës 06.03.2015 kanë sjellë kopje të aktit të marrjes në dorëzim të datës 05.12.2012 për 6 artikuj të koduar, që duhet t'i përkasin faturës nr. 5, datë 26.11.2012 me 44 artikuj të koduar, të cilët kanë arritur në Shqipëri me datë 04.12.2012.

Në të njëjtën datë është mbajtur akt kolaudimi, në fillim të të cilit përcaktohet "Komisioni punoi për marrjen në dorëzim të mallit sipas sasive të mëposhtme, duke u bazuar në kontratën nr. 44/10 prot., datë 05.09.2012 ndërmjetdhe....., për 6 artikuj të koduar.

Pra sipas këtyre dokumenteve janë marrë në dorëzim (pra nuk janë kolauduar, por vetëm marrë në dorëzim) një pjesë e sasisë mallrave të ardhur sipas faturave, saktësisht 6 nga 44 artikujt e koduar.

Nga krahasimi i nënshkrimeve të anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit të kontraktorit....., me ato të dy akteve të tjera, arrin në dyshimin e arsyeshëm për falsifikimin e firmave për.....dhe.....

- Akti i marrjes në dorëzim i datës 05.04.2013 për 26 artikuj që duhet t'i korrespondojë faturës shitësit nr. 2, datë 29.03.2013.

Nga krahasimi i nënshkrimeve të anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesit të kontraktorit....., me ato të dy akteve të tjera, arrin në dyshimin e arsyeshëm për falsifikimin e firmave për..... dhe.....

Po në këtë datë, është mbajtur Akt-kolaudimi për artikujt e mësipërm, duke cilësuar "Komisioni punoi për kolaudimin e mallit duke u bazuar në specifikimet teknike sipas kontratës nr. 44/10 prot., datë 05.09.2012 ndërmjetdhe....., me dyshimin e arsyeshëm për nënshkrime të falsifikuara për.....dhenga krahasimi me dokumentet e mëparshme.

Në tërësi, rezulton se komisioni i marrjes në dorëzim dhe kolaudimit, krahas problematikave të mësipërme, nuk ka marrë në dorëzim dhe nuk ka kolauduar një pjesë të artikujve të materialeve të faturës nr. 235 datë 31.10.2012, si dhe nuk ka kryer testimin përfundimtar për efekt të plotësimit të detyrimeve kontraktore.

7....., në cilësinë e magazinieres së Drejtorisë së përgjithshme të Postës Shqiptare, pasi në magazinimin e mallrave të kontratës "Blerje shtypshkrime" 2014, me nr. 749/8 prot., datë 09.06.2014 lidhur me....., rezulton se sipas fletë daljeve të kontraktorit....., zbatimi i kontratës ka filluar me datë 29.04.2014, pasi është dorëzuar në magazinë artikulli "etiketa adezive RRAA" 8,000 copë me fletëdaljen e tij nr. 1 dhe me fletëdaljen nr. 2 janë dorëzuar 6 rulona. Deri me datën 06.06.2014, sipas dokumenteve fletëdaljeve të kontraktorit të mbajtura nga magazinierja janë dorëzuar në magazinë dy artikuj: "etiketa adezive RRAA" 255,421 copë dhe "etiketa adezive RRAL" 39,560 copë.

Fletëdaljet e kontraktorit ka raste që janë pa firmën marrësit magazinieres (fletëdalja pa numër, datë 21.05.2014; nr. 20, datë 03.06.2014 etj.), herë-herë të palexueshme, dhe/ose vetëm me nënshkrimin e magazinieres....., pa cilësuar emër dhe mbiemër të saj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, pika 36. "Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për

shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve”.

Magazinerja nuk ka numëruar mallin e ardhur të ambalazhuar: etiketa adezive RRAA, RRAL etj., të bërë hyrje rulona, duke i cilësuar se përmbajnë nga njëmijë copë, si dhe Letër për sportelet e shërbimit me “Eternen” A5 dhe A4 duhet të ishin në kuti me 1,400 fije, në fakt janë pranuar me ambalazh kuti me sasi 670, 700, 1000, 1400, 2000 copë, pa verifikuar sasinë brenda ambalazhit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, pika 44.d: *“Verifikimi i sasisë brenda në ambalazh, kur ajo nuk përcaktohet me peshën bëhet duke nxjerrë jashtë ambalazhit njësitë e mallit që janë vendosur në të. Në rast se këto janë vendosur në ambalazhe të jashtëm të paketuara standarde merren në dorëzim sipas shënimeve të bëra mbi paketimin, duke bërë prova me zgjedhje dhe, kur ka diferenca, verifikimi bëhet për gjithë sasinë e mallit. Kur nuk janë të paketuara e të vulosura, merren në dorëzim një për një”*

Sipas dokumenteve të auditit të brendshëm të Posta Shqiptare SHA për kontrollin e ushtruar në magazinën qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme në periudhën 19-24.09.2014, ka rezultuar se nga ana e magazinieres janë bërë dalje pa pasqyruar hyrjen e mallit më parë dhe/ose malli bërë hyrje pa mbërritur fizikisht dhe marrë në dorëzim nga magazinierja. Kjo pasi, nga verifikimi i kartelës nr. 2323 për artikullin “etiketa RRAA”, e cila është çelur 2 herë ku në një rast është pasqyruar hyrje sasi 2,530,000 copë etiketa si furnizim, por në fakt i pa mbërritur fizikisht. Në datë 11.07.2014 magazina nuk ka patur gjendje të artikullit RRAA në sasinë e bërë dalje 7 filialeve prej 1,940,569 copë. Gjithashtu, për artikuj të tjerë pasqyruar në daljet nr. 522 deri 528, të datës 11.07.2014, të cilat për shkak se nuk janë pranuar nga Filialet: kanë kthyer fletëdaljet Filiali Durrës me shkresën nr. 938, datë 24.07.2014, në të cilën evidentohet se “kjo faturë nuk është shoqëruar me mallin përkatës”, pasi nuk ka mbërritur malli i përshkruar në fletëdaljet respektive, për të cilën kanë qenë të detyruar për anulimin e saj. Për të ruajtur vijimësinë e numrit rendor të daljeve janë përpiluar dalje të tjera me këto numra por me numër serie të ndryshme, duke mos pasur përputhje renditja kronologjike e faturave me atë të serisë së tyre, gjë që vërteton faktin e mësipërm. Për këto veprime dhe mosveprime ngarkohet me përgjegjësi magazinierja e cila nuk ka vepruar në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, pikat 34 deri në 50- Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve.

Sipas dokumenteve të pagesave të financës, fletë hyrje tatimore nr. rendor s’ka, datë 15.10.2014 për 1 artikull e firmosur nga blerësi Posta shqiptare Sha, me vlerë 8,119,850 lekë; kopje Fature tatimore e shitësit nr. 325, datë 15.10.2014, për 1 artikull e firmosur nga blerësi Posta shqiptare Sha: magazinier.....; Procesverbal i datës 15.10.2014 nga komisioni i kolaudit dhe përfaqësuesi i kontraktorit ADEL CO, kanë cilësuar: “Grupi i marrjes në dorëzim u thërrit për kolaudit malli që i përket faturës me nr. 325, datë 15.10.2014 me vlerë 8,119.850 lekë, sipas magazinieres është futur në magazinë që në muajin korrik. Pra sipas magazinieres në datën 15.10.2014 firma ka sjellë faturën e këtij malli me nr. 325, datë 15.10.2014. Për sa më sipër grupi i kolaudit dhe i marrjes në dorëzim nuk mund të kolojdoj një mall që nuk është prezent për t’u dorëzuar nga firma kontraktore”. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi magazinieren....., e cila ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, pika 37: *“Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)”*.

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për:

8. Z....., në cilësinë e anëtarit të komisionit për prokurimin me vlera të vogla, pasi: në 5 raste me vlerë 1,957 mijë lekë është përdorur procedura e prokurimit me vlera të vogla për kryerjen e një shërbimi, duke shmangur prokurimin me procedurë tenderimi, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 3 i ndryshuar;

- Në cilësinë e përgjegjësit të financës së Interpost SHPK, pasi në bilancin e paraqitur në fund të vitit 2013, rezulton me gjendje në “Llogari të arkëtueshme tregtare”, në shumën 53,516,201 lekë, në fakt nuk janë klientë për arkëtim por kjo shumë përfaqëson kostot e pajisjeve të kaluara falas nga Interposta SHPK në institucione të tjera, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit. Si pasojë e evidentimit dhe regjistrimit jo të saktë të veprimit kontabël nga financa rezulton në fund të vitit 2013, Interposta SHPK me klientë me kërkesa për arkëtim, kur në fakt nuk janë klientë, por janë shpenzime për të përballuar kostot financiare dhe që duhet të rëndojnë rezultatin financiar të vitit ushtrimor; në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, pika 44 janë kryer pagesat e kontratës “Blerje pajisje rrjeti DC, për shpërndarjen e internetit për implementimin e sistemit DWDM” pa marrjen në dorëzim të mallrave dhe inspektimeve përkatëse.

9. Z....., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të blerjeve me vlera të vogla dhe hartuesve të dokumentacionit pasi: është paguar servisvlera prej 388,800 lekë për riparim automjeti, si rast emergjence, sipas procesverbalit me datë 06.02.2014, si rast urgjent, për defektin e pësuar automjeti i Drejtorit të Përgjithshëm dhe me datën 03.02.2014 është mbajtur procesverbal nga grupi i punës dërguar në vendin e defektit të automjetit, në të cilën përcaktohet se, automjeti me datën 31.01.2014 në kthim nga Rinasi pësoi defekt pasi u fik motori. Nuk është analizuar se, pse automjeti ishte në Rinas kur Drejtori Përgjithshëm me datën 01.02.2014 kthehej nga Boston, që ishte me shërbim, si dhe Procesverbali i komisionit të blerjeve të vogla, përshkruan se nevoja e riparimit ndodhi me datën 03.02.2014, në orën 15 e 30 minuta.

- në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit të kontratës “Blerje shtypshkrime” 2014, pasi sipas procesverbalit të datës 07.02.2014 përcaktimi i fondit limit është bërë duke ju drejtuar zyrtarisht 12 subjekteve me datë 07.02.2014, për të sjellë ofertat brenda datës 07.02.2014. Oferta e sjellë në rrugë jo zyrtare e subjektit është kopje pa datë dhe numër protokolli, po ashtu dhe oferta e Shtypshkronjadhe subjekti pa numër protokolli dhe pa datë, duke e bërë këtë proces formal.

“Pezullim nga e drejta për t’u ngritur në detyrë deri në 1 vit”, për:

10. Zj.....,

11. Z., në cilësinë e anëtarëve të komisionit të procedurës së fushatës publicitare 2013, pasi: me datën 13.03.2013 është hartuar ftesa për negociata për 5 subjekte, të cilat janë marrë dorazi në të njëjtën datë, të konfirmuara nga subjektet. Ftesa për negociata është paraqitur në mënyrë elektronike në faqen e internetit të shoqërisë me datën 02.04.2013, pra krejt formalisht pasi këto ftesa i ishin dërguar subjekteve. Ftesa e paraqitur në formën elektronike në faqen e internetit të shoqërisë është, në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 1195, datë 05.08.2013 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin...”, pasi nuk ka përfshirë të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 10 të VKM, si: objektin e programit/reklamës/spotit, nevojën e kryerjes së programi/reklamës/spotit etj.; vlerësimi i ofertave nga komisioni nuk është bërë në përputhje të plotë me pikën 12 të VKM nr. 1195, datë 05.08.2013, pasi nuk ka bërë vlerësimin në bazë të pikëve për çdo agjenci.

12. Z....., pasi në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për monitorimin e realizimit të fushatës publicitare: në pikën 1.2 të kontratës shprehet se: “agjencia merr përsipër të sigurojë prodhimin e 2 spoteve të rinj televiziv, 1 spot radiofonik dhe layout e gazetave”, kështu

paraqitja e çmimeve për këto prodhime duhej të pasqyrohej për secilin element në vete dhe jo në total; Raporti përfundimtar i hartuar nga komisioni, ka përshkruar dokumentacionin e secilit subjekt pjesëmarrës dhe çmimin, duke shpallur fitues çmimin më të ulët, por nga komisioni nuk përshkruhet se çfarë janë spotet e reja që do të prodhohen nga subjektet që të krahasohej cilësia dhe përmbajtja e tyre dhe jo vetëm çmimi në total, duke sjellë dyshimin e arsyeshëm se shpallja e subjektit fitues ka qenë e paracaktuar;

- Në cilësinë specialistit të Drejtorisë së Marketing, në procedurën e prokurimit shtesë kontrate me objekt “Shtypshkrimi i gazetës Postieri”, ka vepruar jashtë kompetencave të tij në përcaktimin e procedurës së prokurimit, pasi në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, pika 1, germa (ç), është titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar, kur ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj.

“Vërejtje me shkrim”, për:

13. Z....., në cilësinë e Drejtorit të Programim-zhvillimit, pasi ka hartuar dhe dërguar mbi 5 muaj me vonesë programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2013, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, kreu III, pika 5;

- Në cilësinë e kryetarit të grupit të punës të menaxhimit të aseteve financiare, pasi gjatë veprimtarisë së këtij grupi kanë rezultuar mangësi në dokumentacionin e kontratave dhe procedurave të depozitave të shoqërisë.

14. Zj..... në cilësinë e Drejtores së Drejtorisë së Shërbimit Postar, pasi në vitin 2013, nuk janë realizuar të ardhurat nga ky shërbim për 103,812 mijë lekë, me peshën më të madhe në mosrealizim;

- Në cilësinë e anëtares së grupit të punës për të përcaktuar specifikimet teknike për objektin “Fushatë Publicitare në mediat elektronike dhe të shkruar të Posta Shqiptare SHA” për vitin 2013, pasi është paraqitur një relacion pa datë, duke përcaktuar numrin total të spoteve, pa përshkruar llojin e tyre, përmbajtjen, shpeshhtësinë e dhënies së tyre si dhe nuk ka një material mbështetës të hartuar nga Drejtoria e Marketingut, për zhvillimin e kësaj fushate mediatike.

15. Z.....,

16. Z....., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të blerjeve me vlera të vogla dhe hartuesve të dokumentacionit pasi: është paguar servis, vlera prej 388,800 lekë për riparim automjeti, si rast emergjence, sipas procesverbalit me datë 06.02.2014, si rast urgjent, për defektin e pësuar automjeti i Drejtorit të Përgjithshëm dhe me datën 03.02.2014 është mbajtur procesverbal nga grupi i punës dërguar në vendin e defektit të automjetit, në të cilën përcaktohet se, automjeti me datën 31.01.2014 në kthim nga Rinas i pësoi defekt pasi u fik motori. Nuk është analizuar se, pse automjeti ishte në Rinas kur Drejtori Përgjithshëm me datën 01.02.2014 kthehej nga Boston, që ishte me shërbim, si dhe Procesverbali i komisionit të blerjeve të vogla, përshkruan se nevoja e riparimit ndodhi me datën 03.02.2014, në orën 15 e 30 minuta.

17. Zj....., pasi në cilësinë e anëtares së grupit të punës për monitorimin e realizimit të fushatës publicitare: në pikën 1.2 të kontratës shprehet se: “agjencia merr përsipër të sigurojë prodhimin e 2 spoteve të rinj televiziv, 1 spot radiofonik dhe layout e gazetave”, kështu paraqitja e çmimeve për këto prodhime duhej të pasqyrohej për secilin element në vete dhe jo në total; Raporti përfundimtar i hartuar nga komisioni, ka përshkruar dokumentacionin e secilit subjekt pjesëmarrës dhe çmimin, duke shpallur fitues çmimin më të ulët, por nga komisioni nuk përshkruhet se çfarë janë spotet e reja që do të prodhohen nga subjektet që të krahasohej

cilësia dhe përmbajtja e tyre dhe jo vetëm çmimi në total, duke sjellë dyshimin e arsyeshëm se shpallja e subjektit fitues ka qenë e paracaktuar.

18. Zj.....,

19. Zj....., në cilësinë e anëtarëve për përgatitjen e fondit limit, pasi: në procedurën e prokurimit “Blerje zarfe për shërbimin postar” 2013, nuk ka qenë një punë serioze nga ana e këtij grupi pasi kërkesa këtyre subjekteve ju është bërë me datë 25.10.2013 dhe oferta e subjektit “Euro office” është me datë 24.10.2013; të gjitha subjekteve ju është dërguar në rrugë zyrtare, por përgjigja nga ana e subjekteve nuk verifikohet se në çfarë mënyre ka ardhur, duke treguar se procedura e llogaritjes së fondit limit ka qenë formale, si dhe ka tejkaluar kompetencat e veta duke përcaktuar në këtë shkresë sasinë e nevojshme të zarfave sipas llojeve dhe jo vetëm duke analizuar koston e mallrave.

“Këshillim”, për:

20. Z....., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit Postar, pasi në 9-mujorin e vitit 2014, nuk janë realizuar të ardhurat nga shërbimi postar për 86,448 mijë lekë, me peshën më të madhe në mosrealizim.

21. Zj....., në cilësinë e Përgjegjëses së sektorit ekonomik të Filialit të Transitit, pasi me veprimet dhe mosveprimet e saj ka lejuar shpërdorimin e aktiveve të sektorit që mbulon, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 10.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në prokurimet publike për periudhën 01.01.2013 deri më 31.09.2014, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në raportin përfundimtar të auditimit, bazuar në nenin 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 3, kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, **i kërkohet Agjencisë së Prokurimit Publik të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke rekomanduar marrjen e masave administrative apo disiplinore për punonjësit si më poshtë:**

1.,

2....., në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën “Blerje zarfe për shërbimin postar” 2013, pasi: nuk kanë konsideruar si devijime të vogla arsyet e skualifikimit të një operatori, duke i kërkuar sqarime operatorit, pasi vlera e përcaktuar në fondin limit për një artikull ka qenë planifikuar 90,000 lekë dhe diferenca midis këtij ofertuesi dhe të shpallurit fitues ka qenë 776,840 lekë; Operatori ofertues fitues ka paraqitur CV të stafit kryesor përgjegjës për realizimin e kontratës të nivelit nën mesatar;

3....., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën “Blerje kompjutera, printera e lexues barkodesh dhe peshore elektronike” 2013, pasi: në kontratën e bashkëpunimit është përcaktuar ndarja e fitimit dhe jo e pjesëmarrjes; njëri nga ortakët e shpallur fitues nuk ka pasur të vulosura fletët e bilancit; Autorizim prodhuesi nuk konfirmon që është autorizuar për shërbimin e mirëmbajtjes, aq më tepër që sipas marrëveshjes shërbimin e instalimit, të mirëmbajtjes dhe të garancisë do ta kryejë ortakët e tjetër etj.;

- në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën “Blerje lidhëse plastike” 2013: operatori i shpallur fitues ka paraqitur kontratën të cilat nuk janë të ngjashme me lidhëset plastike; kontrata e realizuar nuk i përket vitit të fundit financiar; nuk rezulton asnjë dokument i paraqitur nga operatori fitues, i cili të jetë përfaqësuesi i autorizuar i subjektit prodhues duke e bërë të pavlefshme certifikatën e cilësisë; janë konsideruar të vlefshme analiza të sjella nga

institucione të tjera dhe jo të autorizuar për këtë qëllim, është në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu III, pika 3, shkronja (b) paragrafi (i) lidhur me kërkesat operatorëve ekonomikë që të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit etj.;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së për procedurën e prokurimit “Blerje shtypshkrime” 2014, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues subjektinqë sipas Ekstraktit historik të subjektit ka një përvojë rreth 1 vit; xhiron e vitit 2012 e ka 14,889,400 lekë dhe për vitin 2013 është 47,354,470 lekë pra sa 86 % e fondit limit në vitin e aktivitetit të saj; në CV e subjektit janë paraqitur 4 punonjës me formim nën mesatar; fletë-analiza e letrës nuk është produkt i laboratorëve të licencuar dhe të njohur ligjërisht dhe nuk duhej të ishte marrë në konsideratë nga KVO.

4....., në cilësinë e anëtares së KVO për procedurën “Blerje kompjutera, printera e lexues barkodesh dhe peshore elektronike” 2013, pasi: në kontratën e bashkëpunimit është përcaktuar ndarja e fitimit dhe jo e pjesëmarrjes; njëri nga ortakët e shpallur fitues nuk ka pasur të vulosura fletët e bilancit; Autorizim prodhuesi nuk konfirmon që është autorizuar për shërbimin e mirëmbajtjes, aq më tepër që sipas marrëveshjes shërbimin e instalimit, të mirëmbajtjes dhe të garancisë do ta kryejë ortaku i tjetër etj.;

- në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën “Blerje lidhëse plastike” 2013: operatori i shpallur fitues ka paraqitur kontratën të cilat nuk janë të ngjashme me lidhëset plastike; kontrata e realizuar nuk i përket vitit të fundit financiar; nuk rezulton asnjë dokument i paraqitur nga operatori fitues, i cili të jetë përfaqësuesi i autorizuar i subjektit prodhues duke e bërë të pavlefshme certifikatën e cilësisë; janë konsideruar të vlefshme analiza të sjella nga institucione të tjera dhe jo të autorizuar për këtë qëllim, është në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu III, pika 3, shkronja (b) paragrafi (i) lidhur me kërkesat operatorëve ekonomikë që të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit etj.;

- në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën “Blerje zarfe për shërbimin postar” 2013, pasi: nuk kanë konsideruar si devijime të vogla arsyet e skualifikimit të një operatori, duke i kërkuar sqarime operatorit, pasi vlera e përcaktuar në fondin limit për një artikull ka qenë planifikuar 90,000 lekë dhe diferenca midis këtij ofertuesi dhe të shpallurit fitues ka qenë 776,840 lekë; Operatori ofertues fitues ka paraqitur CV të stafit kryesor përgjegjës për realizimin e kontratës të nivelit nën mesatar;

5. ■■■■■, në cilësinë e anëtares së KVO për procedurën “Blerje lidhëse plastike” 2013: operatori i shpallur fitues ka paraqitur kontratën të cilat nuk janë të ngjashme me lidhëset plastike; kontrata e realizuar nuk i përket vitit të fundit financiar; nuk rezulton asnjë dokument i paraqitur nga operatori fitues, i cili të jetë përfaqësuesi i autorizuar i subjektit prodhues duke e bërë të pavlefshme certifikatën e cilësisë; janë konsideruar të vlefshme analiza të sjella nga institucione të tjera dhe jo të autorizuar për këtë qëllim, është në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu III, pika 3, shkronja (b) paragrafi (i) lidhur me kërkesat operatorëve ekonomikë që të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit etj.;

6....., në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën “Blerje kompjutera, printera e lexues barkodesh dhe peshore elektronike” 2013, pasi: në kontratën e bashkëpunimit është përcaktuar ndarja e fitimit dhe jo e pjesëmarrjes; njëri nga ortakët e shpallur fitues nuk ka pasur të vulosura fletët e bilancit; Autorizim prodhuesi nuk konfirmon që është autorizuar për shërbimin e mirëmbajtjes, aq më tepër që sipas marrëveshjes shërbimin e instalimit, të mirëmbajtjes dhe të garancisë do ta kryejë ortaku i tjetër etj.;

7.....,

8.

9.

10., në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor dhe anëtarëve të KVO pasi: në procedurën e prokurimit “Blerjen e shërbimit të internetit nëpërmjet linjave të interkonjeksionit në pikat Qafë Morinë, Tropojë dhe Morinë Kukës” 2014, nuk është plotësuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues Shtojca 4, Lista e informacionit konfidencial; sigurimi i ofertës i datës 01.07.2014 i BKT nuk është sipas Shtojcës 3; ka paraqitur bilancin e vitit 2012 dhe 2013, certifikimi i pa vulosur në versionin shqip dhe mungon versioni në origjinal anglisht, nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë autoriteti përkatës; megjithëse këto kontrata me vlerë gjithsej 3,161.5 euro nuk janë dëshmi të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, pasi nuk provohet se janë realizuar; të konvertuar në 505,000 lekë përbëjnë 4 % të fondit limit, në kundërshtim me dokumentet e tenderit që duhet të jenë në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit që prokurohet; operatori ofertues fitues nuk ka paraqitur autorizim përfaqësimi i distributorëve internacional të nivelit të parë etj.

11....., në cilësinë e anëtarit të KVO-së për procedurën “Shtesë kontrate me objekt Shërbimi intranet në zyrat Qendër në Filiale e degë” 2013, sipas procesverbalit të datës 26.08.2013 të KVO-së është zhvilluar procedura e negocimit me përfaqësuesin e subjektit Idea-Tel, në të cilën theksohet se përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ka paraqitur kërkesën për pjesëmarrje shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Ofertën e ekonomike, Deklaratën mbi konfliktin e interesit, Deklaratën për përmbushjen e specifikave teknike. Në dosjen e kësaj procedure prokurimi nuk ndodhet kërkesa për pjesëmarrje e kontraktorit; Oferta ekonomike mban datën 28.08.2013, si dhe Deklarata mbi konfliktin e interesit e Deklarata për përmbushjen e specifikave teknike mbajnë datën 27.08.2013, gjë që tregon se procesverbali i datës 26.08.2013 është mbajtur formalisht nga ana e KVO;

- në cilësinë e anëtarëve të KVO-së për procedurën “Shoqërimi i ruajtjes së objekteve dhe personelit me roje të kategorisë 1.3. A” 2014, pasi është kualifikuar subjekti megjithëse nuk ka plotësuar kërkesat ligjore të specifikimeve teknike: Për dokument që disponon sallë operative (pika 7 e specifikimeve teknike) është paraqitur kontratë shitje (paraprake) e një apartament banimi në Tiranë, e pa noterizuar e datës 09.10.2012 në të cilën shkruhet për t’u dorëzuar me datë 30.09.2012, pra që nuk vërtetohet me dokumente hipotekore se zotëron një sipërfaqe të tillë; ka paraqitur Licencën e lëshuar nga METE nr. LN-200-09-2010 me kod 1.3 A me datë të vlefshmërisë 03.09.2014, në një kohë që data e tenderit është 14.07.2014 me afat shërbimi 12 muaj, pra pas kësaj date operatori nuk do të ketë licencim të vlefshëm; ka paraqitur leje qarkullimi për një mjet BC1090B i cili që nga viti 10.11.2009 nuk ka kryer kontrollin periodik vjetor, pra si rregull nuk duhet të qarkullojë ose në se qarkullon mund të bllokohet nga organet përkatëse të policisë rrugore; subjekti kualifikuar dhe shpallur fitues nuk ka paraqitur Leje individuale për armë krahu (automatik) për çdo vend roje; pasi uniforma e tij nuk përputhet me ato të këtij operatori, si dhe nuk është salla operative dhe kapacitetet kryesore teknike dhe profesionale të shoqërisë etj; ka vepruar me dy standarde për subjektin duke e skualifikuar në disa lote dhe duke e kualifikuar për lotin e Vlorës për të njëjtin shkak etj.

12....., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së për procedurën “Shtesë kontrate me objekt Shërbimi intranet në zyrat Qendër në Filiale e degë” 2013, sipas procesverbalit të datës 26.08.2013 të KVO-së është zhvilluar procedura e negocimit me përfaqësuesin e subjektit Idea-Tel, në të cilën theksohet se përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ka paraqitur kërkesën për pjesëmarrje shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Ofertën e ekonomike, Deklaratën mbi konfliktin e interesit, Deklaratën për përmbushjen e specifikave teknike. Në dosjen e kësaj procedure prokurimi nuk ndodhet kërkesa për pjesëmarrje e kontraktorit; Oferta ekonomike mban datën 28.08.2013, si dhe Deklarata mbi konfliktin e interesit e Deklarata për

përmbyshjen e specificeve teknike mbajnë datën 27.08.2013, gjë që tregon se procesverbali i datës 26.08.2013 është mbajtur formalisht nga ana e KVO.

13....., në cilësinë e anëtares së KVO-së për procedurën e prokurimit “Blerje shtypshkrime” 2014, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues subjektin që sipas Ekstraktit historik të subjektit ka një përvojë rreth 1 vit; xhiron e vitit 2012 e ka 14,889,400 lekë dhe për vitin 2013 është 47,354,470 lekë pra sa 86 % e fondit limit në vitin e aktivitetit të saj; në CV e subjektit janë paraqitur 4 punonjës me formim nën mesatar; fletë-analiza e letrës nuk është produkt i laboratorëve të licencuar dhe të njohur ligjërisht dhe nuk duhej të ishte marrë në konsideratë nga KVO.

14.....,

15....., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së për procedurën “Shoqërimi i ruajtjes së objekteve dhe personelit me roje të kategorisë 1.3. A” 2014, pasi është kualifikuar subjekti “Trezhnjeva” megjithëse nuk ka plotësuar kërkesat ligjore të specifikimeve teknike: Për dokument që disponon sallë operative (pika 7 e specifikimeve teknike) është paraqitur kontratë shitje (paraprake) e një apartament banimi në Tiranë, e pa noterizuar e datës 09.10.2012 në të cilën shkruhet për t’u dorëzuar me datë 30.09.2012, pra që nuk vërtetohet me dokumente hipotekore se zotëron një sipërfaqe të tillë; ka paraqitur Licencën e lëshuar nga METE nr. LN-200-09-2010 me kod 1.3 A me datë të vlefshmërisë 03.09.2014, në një kohë që data e tenderit është 14.07.2014 me afat shërbimi 12 muaj, pra pas kësaj date operatori nuk do të ketë licencim të vlefshëm; ka paraqitur leje qarkullimi për një mjet BC1090B i cili që nga viti 10.11.2009 nuk ka kryer kontrollin periodik vjetor, pra si rregull nuk duhet të qarkullojë ose nëse qarkullon mund të bllokohet nga organet përkatëse të policisë rrugore; subjekti kualifikuar dhe shpallur fitues nuk ka paraqitur Leje individuale për armë krahu (automatik) për çdo vend roje; pasi uniforma e tij nuk përputhet me ato të këtij operatori, si dhe nuk është salla operative dhe kapacitetet kryesore teknike dhe profesionale të shoqërisë etj; ka vepruar me dy standarde për subjektin duke e skulifikuar në disa lote dhe duke e kualifikuar për lotin e Vlorës për të njëjtin shkak etj.

E. KALLZIM PENAL

Bazuar në nenet: 164 të shpërdorimit të kompetencave dhe 248 të shpërdorimit të detyrës të Kodit Penal, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të mësipërme, për personat si më poshtë:

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281 me shkresën nr. ..., datë është bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë

1.z....., në cilësinë e Drejtorit të përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA;

2.z....., në cilësinë e Administratorit të Përgjithshëm të Interposta SHPK;

3. z....., në cilësinë e Drejtorit të Tranzitit,

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Gjovalin Preci, Luljeta Shtylla, Lavdie Fshazi, Artan Topjnana dhe Migena Nushi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Ilizai, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.

